



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë	
Kopje:	Agim Veliu, Kryetar i Komunës së Podujevës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqëse e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 11/12/2019 Nr.020-1253
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave 2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse Kujtim Aliu Zyrtar për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Podujevës	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Podujevës	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar Vendimin NR. 01-016/01-0091825/19 për kushtet, mënyrën dhe kohëzgjatjen e shfrytëzimit të shtëpive të banimit në pronësi të komunës në lagjen e dëshmorëve në fshatin Balloc, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Podujevës, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 7, të Rregullores (QRK) Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimin NR. 01-016/01-0091852/19 për kushtet, mënyrën dhe kohëzgjatjen e shfrytëzimit të shtëpive të banimit në pronësi të komunës në lagjen e dëshmorëve në fshatin Balloc

I miratuar më datë: 05.12.2019

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 10.12.2019




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Mbështetur në nenet 11 dhe 12.2 shkronja d), neneve 14.1 dhe 17 shkronja k) të Ligjit për vetëqeverisje lokale 03/L-040, neneve 4 dhe 7 të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit, nr.031-164, Ldhëzimit Administrativ 18/2010, nenit 10.2 të Rregullores së Kuvendit të Komunës së Podujevës për caktimin e kriterëve për dhënie e shtëpive në shfrytëzim në Lagjen e Dëshmorëve në Balloc nr.01-463-45840 të datës 27 maj 2014, Vendimit të Kuvendit të Komunës për ngritjen e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, nr. 01-020/04-0026812/18 të datës 28.03.2018, në zbatim të Programit Trevjeçar të Banimit 2019-2021, në Komunën e Podujevës, i miratuar me Vendimin nr. 01-360/01-0060753/19 të datës 29 korrik, 2019, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen mbajtur më 05 dhjetor 2019,

Në Rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa nga mbledhja e mbajtur më 03 dhjetor 2019, në Rekomandim të Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, merr,


 Ministry of Local Government Administration
 10-12-2019
 Nr. 020 + 1253

VENDIM
PËR KUSHTET, MËNYRËN DHE KOHËZGJATJEN E SHFRYTËZIMIT TË
SHTËPIVE TË BANIMIT NË PRONËSI TË KOMUNËS NË LAGJEN E DËSHMORËVE
NË FSHATIN BALLOC

Neni 1

Me këtë vendim përcaktohen kushtet, mënyra dhe kohëzgjatja e shfrytëzimit të shtëpive të banimit në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, të rekomanduara nga Komisioni i Kuvendit të Komunës për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në fshatin Balloc, Komuna e Podujevës, i cili është edhe pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 2

Kushtet, mënyra dhe kohëzgjatja sipas këtij vendimi përcaktohen në Kontratë e cila do të lidhet mes Organit kompetent të Komunës dhe përfituesit/shfrytëzuesit të përkohshëm të shtëpisë së banimit.

Neni 3

Kohëzgjatja e shfrytëzimit të shtëpive nga ana shfrytëzuesve është e përkohshme përkatësisht me afat të pacaktuar, deri në marrjen e një vendimi tjetër nga ana e Komunës varësisht rrethanave të krijuara sa i përket statusit të gjendjes ekonomike të familjeve përfituese të shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve.

Neni 4

Shfrytëzimi i shtëpive nga ana e përfituesve është pa kompensim/qira, deri në marrjen e një vendimi tjetër.


Neni 5

Cështje tjera që nuk janë të përcaktuara në këtë vendim, përkatësisht në rekomandimin e cekur, vlejnë dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Neni 6

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në web faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafit 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunës.

Nr.01-016/01-0091852/19
 Podujevë, 05 dhjetor 2019



Presidenti i Kuvendit
 Fatmir Gashi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

KOMISIONI PËR NDARJEN E SHTËPIVE NË PRONËSI TË KOMUNËS NË LAGJEN E DËSHMORËVE NË FSHATIN BALLOC

Mbështetur në nenit 10 të Rregullores së Kuvendit të Komunës së Podujevës për caktimin e kritereve për dhënie e shtëpive në shfrytëzim në Lagjen e Dëshmorëve në Balloc nr.01-463-45840 të datës 27 maj 2014, dhe nenit 2 të Vendimit të Kuvendit të Komunës për ngritjen e Komisionit për ndarjen e shtëpive në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, nr. 01-020/04-0026812/18 të datës 28.03.2018, si dhe Programin Trevjeçar të Banimit 2019-2021, në Komunën e Podujevës, i miratuar me Vendimin nr. 01-360/01-0060753/19 të datës 29 korrik, 2019.

Nga takimi i mbajtur më 03 dhjetor 2019.

REKOMANDON

Kushtet, mënyrën dhe kohëzgjatjen e shfrytëzimit të shtëpive të banimit në pronësi të Komunës në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc, që do të përfshihen në kuadër të Kontratës e cila do të lidhet mes organit kompetent të Komunës dhe përfituesit-shfrytëzuesit të përkohshëm, ndër të tjera, si vijon:

Objekt i Kontratës të jetë dhënia përkatësisht marrja në shfrytëzim të përkohshëm të shtëpisë së banimit, sipas projektimit të hapësirës përkatëse në Lagjen e Dëshmorëve, në fshatin Balloc, Komuna e Podujevës.

Pajtimi mes palëve që shtëpia e banimit të shfrytëzohet nga bartësi i të drejtës përfshirë edhe anëtarët e familjes, sipas evidencës që posedon sektori përkatës i Komunës.

Komuna i dorëzon shfrytëzuesi objektin / shtëpinë e banimit, në gjendje të rregullt, nuk mban përgjegjësi për riparimin e dëmtimeve të mundshme që mund të shkaktohen pas dorëzimit të objektit / shtëpisë së banimit nga ana e shfrytëzuesit, përveç rasteve kur vlerësohet se riparimet janë të natyrës së përgjithshme apo që eventualisht shkaktohen nga forca madhore, mban të drejtën e kontrollit të mirëmbajtjes së shtëpisë (në praninë e shfrytëzuesit), si dhe siguron shfrytëzimin e pa penguar të saj, mundëson përdorimin e lirë dhe posedimin e shtëpisë nga ana e shfrytëzuesit, dhe nuk do të kryej me punime të cilat do të mund të ndikojnë në kushtet normale të jetesës së shfrytëzuesit përveç në rastet urgjente nëse vlerësohet e nevojshme.

Përfituesi – shfrytëzuesi, Shfrytëzon objektin / shtëpinë e banimit, ekskluzivisht për qëllim të banimit, detyrohet që me rregull të paguaj shpenzimet në emër të shërbimeve komunale dhe shërbimeve tjera siç janë, energjia elektrike, uji, mbeturinat etj. të mos ketë të drejtë bartjen e të drejtës së shfrytëzimit të shtëpisë dhe hapësirës përkatëse - oborrit, personave të tretë, që objektin / shtëpinë ta shfrytëzoj me mirëbesim në përputhje me rendin shtëpiak n'kuadër të Lagjes, dhe që eventualisht pas rrethanave tjera të krijuara shtëpinë ta dorëzoj / kthej titullarit, në gjendjen e pranimit.

Dorëzimi dhe pranimi i shtëpisë bëhet me procesverbal të nënshkruar nga palët, në të cilin ndër të tjera pasqyrohet gjendja e shtëpisë në tërësi dhe inventari, pajisjet dhe elementet tjera të vendosura. Procesverbali të mbahet nga zyrtari përgjegjës dhe i njëjti është pjesë përbërëse e kontratës.

Kohëzgjatja e shfrytëzimit të shtëpisë të jetë në afat të pacaktuar, deri në një vendim tjetër dhe rrethanave tjera të krijuara sa i përket statusit të gjendjes ekonomike etj. të familjeve në Lagjen e Dëshmorëve, nga data e nënshkrimit të kontratës, me mundësi të vazhdimit.

Shuma mujore e shfrytëzimit, në emër të qirasë, të jetë zero (0) euro, deri në marrjen e një vendimi tjetër.

Si dhe çështje tjera të parapara me legjislacionin përkatës në fuqi.

Podujevë,
03 dhjetor 2019

Komisioni

Agim Behluli 
Valbona Kadriu – Podvorica 
Vendenis Lahu 
Fatmir Rudari 
Musa Jakupi 